




Ndal Punës së Fëmijëve

**Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias**

Debati

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Studimi, përgatitja dhe zhvillimi i një debati publik për punën e fëmijëve.



Përfundimi: Zhvillimi i aftësive shprehëse, diskutuese dhe komunikuese. Moduli ndihmon në ndëgjegjësimin e komunitetit.

Koha

Tri orë mësimi të veçanta dhe dy orë mësimi së bashku. Mund të shfrytëzohen dhe më shumë orë, nëse zhvillohen veprimtaritë fakultative.



Motivimi

Në shoqërinë demokratike debati është një veprimtari themelore. Dy mijë vjet më parë, kur lindi shoqëria demokratike në Athinë të Greqisë, qytetarët mblidheshin rregullisht në asamblenë e tyre për të diskutuar dhe për të votuar politikën dhe veprimtaritë e shtetit. Qytetarët vendosnin nëse Athina do të hynte në luftë apo jo, me çfarë mjetesh do të luftonte, si dhe përgatisnin ligje që rregullonin jetën e tyre familjare. Gjithmonë votimi paraprihej nga debati, ku qytetarët dhe pushtetarët diskutonin për gjithçka që vendosnin. Diskutonin për saktësinë dhe ligjshmërinë e veprimeve, si dhe për mënyrën më të mirë për të realizuar objektivat e dëshiruar.

Shënim për përdoruesin

Ky modul është mirë të zhvillohet pasi të jenë realizuar mëse gjysma e moduleve të paketës. Që të dalë me sukses, të rinjtë të kenë njohuritë e nevojshme për dukurinë e punës së fëmijëve, si dhe të dinë të zhvillojnë një proces kërkimi. Gjatë zhvillimit të modulit të rinjtë duhet të përcaktojnë një qëndrim të caktuar në lidhje me çështjen që debatohet, si dhe të japin argumentet e duhura për të mbrojtur zgjedhjen e tyre. Ju këshillojmë që ky modul të zhvillohet pas modulit “Kërkimi dhe informacioni”. Do të ishte mirë që të keni zhvilluar dhe modulën e shkrimit krijues. Gjithashtu, ky modul mund të zhvillohet para ose pas modulit “Dramatizimi”.



Shënim për përdoruesin

Ky modul është mirë të zhvillohet pasi të jenë realizuar mëse gjysma e moduleve të paketës. Që të dalë me sukses, të rinjtë të kenë njohuritë e nevojshme për dukurinë e punës së fëmijëve, si dhe të dinë të zhvillojnë një proces kërkimi. Gjatë zhvillimit të modulit të rinjtë duhet të përcaktojnë një qëndrim të caktuar në lidhje me çështjen që debatohet, si dhe të japin argumentet e duhura për të mbrojtur zgjedhjen e tyre. Ju këshillojmë që ky modul të zhvillohet pas modulit “Kërkimi dhe informacioni”. Do të ishte mirë që të keni zhvilluar dhe modulën e shkrimit krijues. Gjithashtu, ky modul mund të zhvillohet para ose pas modulit “Dramatizimi”.

Ende sot debati është element kryesor i demokracisë edhe pse ky proces ka pësuar ndryshime dhe nuk është i njëjtë me debatin athinas, pasi tani vendet moderne kanë një popullatë dhe shtrirje gjeografike shumë më të madhe. Sot, debati zhvillohet në sallat e parlamentit apo në varësi të problemit dhe komunitetit që i drejtohet, debati zhvillohet në salla konferencash, si dhe në vende publike. Ndodh që debatet të zhvillohen në auditoret e shkollave të të gjitha niveleve, në faqet e gazetave dhe të revistave, në radio dhe televizion. Ashtu siç ndodhte edhe në antikitet, edhe tani njerëzit diskutojnë rreth çështjeve me interes shoqëror, diskutojnë ligje dhe politika ndërhyrjeje që i gjykojnë të nevojshme.

Pjesëmarrja në debat i ndihmon të rinjtë të gjejnë argumente pro dhe kundër një teme të caktuar. Fillojnë të kuptojnë se informacioni dhe njohuritë që kanë marrë, kanë një zbatim praktik. Mund të shfrytëzojnë aftësitë që kanë fituar, p.sh., në fushën e kërkimit. Kuptojnë se të gjitha problemet kanë dy pamje. Në këtë vështrim, edhe problemi i punës së fëmijëve është i tillë. Puna e fëmijëve është një problem kompleks, prandaj nuk ka përgjigje të thjeshta. Nuk është e lehtë të jesh kundër një argumenti që moralisht duket të jetë i saktë, por është edhe më e vështirë të paraqesësh argumente bindëse për të. Ky ushtrim përforcon aftësitë shoqërore dhe komunikuese, kërkon disiplinë dhe aftësi për të folur në publik, kërkon një mendje që operon me logjikë të fortë dhe që është në gjendje të mbrojë një tezë.

Nëpërmjet punimit të këtij moduli të rinjtë duhet të ndëgjegjësohen si për problemet që u takojnë drejtpërdrejt, edhe për ato që i takojnë të gjithë shoqërisë. Ky modul përpiqet që t'i bëjë ata përgjegjës për disa çështje parësore. Synimi është shumëplanësh. Së pari, moduli përforcon përvetësimin e informacionit të marrë më parë, duke thelluar kuptimin e tij. Të rinjtë duhet të përgatisin argumente dhe deklarata për bazën e informacionit që kanë marrë, si dhe nga mbështetja e informacionit të ri që do të marrin në procesin e kërkimit.

Me ndihmën e edukatorit zhvillohen teza dhe argumente që do të pasurohen më tej gjatë procesit

të të mësuarit. Në një farë mënyrë, të rinjtë futen në rolin e fëmijës që punon, të punëdhënësit, të autoriteteve dhe të subjekteve të tjera që kanë lidhje me problemin, dhe më pas aftësohen të mbështesin qëndrimin e tyre. Nuk është e thënë që ta pranojnë çështjen që duhet të mbrojnë, por edhe kjo, nga ana e vet, është një përvojë me vlerë për procesin e të nxënit. Duhet të kuptojnë edhe vendin e kundërshtarit të ideve.



Përgatitja

Debati formal ka rregulla dhe procedura specifike që kërkon kohën e duhur për t'u përgatitur. Meqë kërkohet një kohë relativisht e gjatë për ta përgatitur, ju mund t'i paraqisni grupit një teknikë debati më pak formal, "debatin e lëvizshëm", që përshkruhet në veprimtarinë nr.1. Në këtë rast duhet më pak kohë për përgatitjen paraprake dhe zhvillimin e debatit.

Shtesa1 përmban një sërë rregullash dhe teknikash të zhvillimit të debatit dhe u vjen në ndihmë atyre që nuk kanë përvoja të mëparshme, si dhe i ndihmon të kuptojnë se si organizohen dhe manaxhohen debatet. Gjithashtu, një informacion i tillë ndihmon edukatorin dhe grupin të kuptojnë rolin që kanë në debat, dhe mënyrën si duhet të diskutojnë.



Rregullat e parashtuara në shtesën 1 i përkasin traditës më të njohur të zhvillimit të debatit. Gjithësesi, përdorimi i tyre të bëhet me kujdes nga edukatorët, duke ruajtur dhe duke respektuar traditën e vendit të vet. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen edhe me literaturën për debatin që mund ta gjejnë në bibliotekë dhe në internet. Për realizimin e modulit, mund t'u kërkojnë ndihmë edhe shoqatave që merren me këtë problem ose sindikatave (si ndihmë e jashtme).

Në modul përdoren disa terma të veçantë, por në përdorimin dhe shpjegimin e tyre duhet të jeni elastikë. P.sh., në vend të përdorimit të termit *argumentim* për të shpjeguar përmbajtjen e debatit, mund të shpjegoni konceptin duke folur për *pozicionim* ose *bindje*. Nëse komuniteti juaj ka një traditë në përdorimin e debatit, kjo

përvojë pa dyshim e lehtëson punën tuaj.

Moduli ofron alternativa në lidhje me aspekte të ndryshme të debatit: bëhet fjalë për një koncept shumë elastik dhe të përshtatshëm që u krijon hapësirën e duhur edukatorëve për të mos u frenuar nga të ashtuquajtura “rregulla” të debatit

Ndihma e jashtme

Realizimi i këtij moduli nuk është i vështirë. Nëse projekti zhvillohet në shkollë, mund të ndodhë që në të të marrin pjesë edhe mësues të tjerë, krahas mësuesve të përfshirë në projekt. Një përfshirje e tillë, më e gjerë, do të përforcojë procesin e ndëgjegjësimit të komunitetit. Gjithësesi, përpiquni që të gjithë pjesëtarët e grupit të marrin pjesë aktivisht në realizimin e modulit.

Gjithashtu, duhet ta dini se disa organizata kanë një përvojë shumë të pasur në çështjet e debatit, siç janë sindikatat që arrijnë qëllimet e tyre duke debatuar në mënyrë demokratike. Mocionet diskutohen në konferenca dhe takime dhe mbi këtë bazë merren vendimet. Në kuadrin e procesit të ndëgjegjësimit të komunitetit, grupi mund të vendosë lidhje me selinë e sindikatës lokale për t'i kërkuar që, nëse ka mundësi, t'i ndihmojë në çështje të tilla, si teknikat e ballafaqimit dhe të organizimit të një debati publik. Shumë nga këto organizata të sindikatave mund t'ju vënë në dizpozicion materialet që kanë.

Çfarë duhet

- ✓ Letër, laps dhe penë;
- ✓ Materiale studimore për punën e fëmijëve (IPEC dhe burime të tjera);
- ✓ Internet kur është e mundshme;
- ✓ Një mjedis i përshtatshëm ku do të zhvillohet debati dhe nëse debati i drejtohet një publiku më të gjerë ku do të marrin pjesë dëgjues të jashtëm;
- ✓ Në rastet e debatit lëvizës, një mikrofoni apo alto-parlant.



Zhvillimi i modulit

1 orë mësimi

Hapi i parë lidhet me informacionin që u jepet të rinjve në lidhje me atë se çfarë është debati dhe cili është roli i tij në procesin edukativ. Takimi i parë duhet të jetë një bisedë e lirë, ku të rinjtë ulen rreth edukatorit dhe nuk mbajnë shënime.

Nëse do të zhvilloni vetëm veprimtarinë nr.1, debatin lëvizës, kaloni drejtpërdrejt te kjo veprimtari, duke e anashkaluar pjesën tjetër. Nëse dëshironi t'i paraqisni grupit një debat formal, duhet t'i lini më shumë kohë diskutimit si funksionon ai.

Nëse e vlerësoni si të dobishme, mund t'i referoheni shtesës 1 ose traditës së vendit në çështje debati. Shpjegoni se çfarë është debati duke marrë si shembull një çështje dhe caktoni dy persona ose dy nëngrupe që të paraqesin argumente pro dhe kundër çështjes, përpara një publiku apo një komiteti me gjyqtari. Me pak fjalë, argumentet që paraqiten, duhet të jenë bindëse dhe të ngjallin interesin dhe mbështetjen e publikut o të gjyqtarëve. Në varësi të asaj që ka vendosur grupi dhe mësuesi, publiku mund të bëjë pyetje dhe të përkrahë qëndrimin e njërit apo të tjetrit grup.



Grupit i thuhet të zgjedhë një udhëheqës, si dhe i përcaktohet koha që ka në dispozicion për të paraqitur çështjen ku përfshihen deklaratat dhe përpunimi i strategjisë për paraqitjen e argumenteve. Kjo kohë, p.sh., mund të jetë deri në sesionin e ardhshëm. Qëllimi kryesor i veprimtarisë është përvetësimi i procesit të kërkimit për të gjetur argumentet pro dhe kundër çështjes që debatohet. Meqë në këtë modul problemi që do trajtohet, lidhet me disa aspekte të punës së fëmijëve, grupit i duhet të studiojë të gjitha informacionet bazë që ka në dispozicion për të.

Ndihmojini në përgatitjen e deklaratës dhe theksoni faktin që ajo nuk duhet të jetë e gjatë dhe e ndërlikuar. Për të mbrojtur një çështje, një qëndrim apo një tezë, është shumë e rëndësishme të shpreheni shkurt, qartë dhe saktësisht, duke iu drejtuar shembujve kuptimplotë. Duhet t'i shpjegoni grupit se parashtrimi i problemit është shumë i rëndësishëm, madje për këtë gjë secili duhet të ushtrohet duke përdorur teknika të caktuara për paraqitjen në publik. Edhe në këtë rast, nëse keni mundësi, siguroni ndihmën e një personi të jashtëm.

Pasi keni përcaktuar skuadrat dhe ato janë gati të punojnë për hartimin e deklaratës, nevojitet një mjedis i qetë, në të cilin do të diskutohen strategjitë që do të ndjekin, do të kryejnë kërkimin dhe do të përgatisin paraqitjen e materialit. Në këtë fazë, të rinjtë kanë shumë nevojë për mbështetjen e edukatorit. Mjedisi më i mirë është një klasë ku të gjithë janë të ulur në banka dhe i kanë materialet për të shkruar.

Për zhvillimin e debatit lëvizës, është mirë të punohet me të gjithë grupin. Pjesëtarëve të veçantë u caktohet si detyrë të shprehen para gjithë grupit. Është një e drejtë themelore e të gjithëve, përfshirë këtu dhe fëmijët, që të shprehin lirshëm mendimin e tyre. Njëkohësisht, një ndër synimet e debatit lëvizës është që individë të veçantë të shprehen në këtë mënyrë.

Një debat më formal mund të jetë një veprimtari e grupit e konceptuar si një ballafaqim një për një. Pra, qëllimi është të nxiten të rinjtë të shprehen dhe, për rrjedhojë, të rriten dhe të fitojnë pjekuri si individë. Nëse keni një grup të madh, krijoni skuadra me dy ose tre veta secila (tre është një numër i zakonshëm, por dhe mund të ndryshojë). Kujtoni se të gjithë pjesëtarët e skuadrave duhet të flasin për të njëjtën çështje. Pra, duke kufizuar numrin e anëtarëve të skuadrave, do të mënjanonit përsëritjet e argumentimeve. Gjithësesi, nëse grupi është i madh, mund të trajtohen dy ose tri çështje.

Nëse dëshironi të zbatoni me përpikmëri të gjitha rregullat e debatit, duhet të zgjidhni dhe një komitet gjyqtarësh (shiko shtesën 1), të cilët, mbi bazën e diskutimeve dhe të paraqitjes, vendosin për rezultatin e debatit. Numri i arbitërve duhet të jetë tek, në mënyrë që të shmagni vendimet me vota të barabarta. Zakonisht numri i arbitërve është 3. Edhe në këtë rast, arbitrat duhet të zgjidhen nga grupi, në mënyrë që të gjithë të jenë pjesëmarrës. Gjithësesi, në kuadrin e përfshirjes më të gjerë të komunitetit, mund të vendosni që juria të përbëhet nga persona të jashtëm, p.sh., nga nxënës të një klase tjetër ose të një shkolle tjetër.

Pasi te keni zgjedhur përbërjen e skuadrave dhe të jurisë mendoni me kujdes si do të jetë dinamika e zhvillimit të veprimtarisë. Nëse e njihni përbërjen e grupit dhe e dini që ka në të elementë që mund të zhvillojnë shumë mirë këtë veprimtari, ndajini ata në nëngrupe të ndryshme. Madje këto nëngrupe duhet të mbrojnë tezat më të vështira.

Organizimi i grupit



Publiku

Një debat është më nxitës, tërheqës dhe i këndshëm kur zhvillohet në praninë e publikut. Nëse nuk keni mundësi të mbledhni një publik të caktuar dhe nëse numri i pjesëmarrësve në grup e lejon, një pjesë e tyre mund të jetë në rolin e publikut. Por, nëse projekti zhvillohet në një shkollë apo në një mjedis tjetër ku ka prani të të rinjve, është mirë që këta të ftohen të dëgjojnë debatin, madje dhe të marrin pjesë në të. Kjo është shumë e rëndësishme për tri arsye:

- Skuadrat do të jenë më shumë të motivuara gjë që do t'i bëjë tepër aktive. Të rinjtë do t'i drejtohen një publiku që është bashkëmoshatar dhe ky aspekt do të theksojë paraqitjen e tyre.
- Publiku do të bëhet zëdhënës i tematikës së debatit, duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit. Vetë fakti që të rinjtë apo bashkëmoshatarët e fëmijëve që punojnë trajtojnë problemin e punës së fëmijëve, rrit vlerën që ka mesazhi që ata përcjellin.
- Prania e publikut do të rrisë sigurinë dhe vetëvlerësimin e të rinjve pjesëmarrës në debat, pasi në përfundim të tij do të ndërgjegjësohen se ata janë transmetues të njohurive dhe argumentave që ata vetë kanë njohur jo shumë kohë më parë.

Nga ana tjetër, ju vetë mund t'i nxisni të rinjtë e publikun që të luajnë rolin e arbitrit. Pra, kur raportuesit kanë përfunduar dhe përmbledhtasi janë dhënë të gjitha argumentimet pro dhe kundër, publiku, nëpërmjet një procesi thellësisht demokratik, do të vlerësojë me votë. Më pas, dy përfaqësues të zgjedhur rastësisht nga publiku, do të shpjegojnë arsyet e votimit pro ose kundër raportimit.

Në varësi të objektivave dhe synimeve të grupit në debat mund të ftoni të marrin pjesë edhe prindër, mësues, përfaqësues të mjeteve të komunikimit etj.

Veprimtaria 1: “Debati lëvizës”

2 orë mësimi

Teknika e zhvillimit të debatit që po ju paraqesim, është një mënyrë për të zhvilluar një debat të këndshëm, duke krijuar një lidhje besimi ndërmjet pjesëmarrësve në debat. Kjo metodë përdoret nga organizata të ndryshme në botë, edhe nga shoqatat pacifiste, në mënyrë që t'i ndihmojnë grupet e njerëzve që kanë mendime të kundërta të diskutojnë dhe të debatojnë në një atmosferë respekti reciprok.

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që t'i ndihmojë të rinjtë të kuptojnë se për çdo problem ka të paktën dy mënyra si mund të paraqitet dhe se asnjëra prej tyre, në tërësi, nuk është detyruesisht e gabuar ose e drejtë. Nëse ky ushtrim zhvillohet me korrektësi, krijon mjedisin e duhur të besimit, të respektit dhe të mirëkuptimit në grup në mënyrë të tillë që të gjithë të ndiehen të lirë të shprehin opinionet e tyre me besimin se po dëgjohen nga të tjerët dhe vlerësohen prej tyre. Gjithashtu, i ndihmon të rinjtë të kuptojnë se kur janë të bindur në idetë dhe mendimet e tyre, pavarësisht nëse përkojnë apo jo me mendimin e shumicës, duhet të kenë kurajon t'i paraqesin pa patur frikë se do të vihen në lojë. Kjo veprimtari u jep mundësi të rinjve të kuptojnë parimin e respektit të reciprocitetit dhe lirisë themelore, siç është ajo e lirisë së fjalës.

Nga ana tjetër, kjo mënyrë, i ndihmon të rinjtë që nuk kanë krijuar një ide apo bindje të tyre, të zgjedhin qëndrimin pro ose kundër një argumenti. Në këtë ushtrim të rinjtë mund të përgjigjen që nuk e dinë apo që nuk janë të sigurtë. Gjithësesi, elementi më i rëndësishëm i këtij ushtrimi është fakti që ata mund të ndryshojnë mendim në çdo moment, pasi të kenë dëgjuar mendimet dhe qëndrimet e të tjerëve. Për të rinjtë është shumë e rëndësishme të kuptojnë se duhet të jenë fleksibël, të ndryshojnë mendim apo të bashkohen me mendimin e të tjerëve. Ata, gjithashtu, duhet të kuptojnë se nuk është gjithmonë pozitive të mbeten robër të ideve apo mendimeve të tyre deri në atë pikë sa të mos pranojnë


se interpretimi që mund t'i kenë bërë një argumenti të caktuar, mund të jetë i gabuar. Një qëndrim i tillë është burimi i shumë problemeve dhe që ka shoqëria e sotme, veçanërisht shoqëritë që janë të përfshira në konflikte.

Mirë është që kjo veprimtari të zhvillohet në një mjedis të bollshëm ku mund të qëndrojnë lirshëm anëtarët e grupit dhe publiku.

Rregullat e lojës

Mblidhni të rinjtë në qendër të sallës dhe shpjegojuni rregullat e ushtrimit:

- Do të thoni me zë të lartë titullin e debatit;
- Ata që e pranojnë tezën e paraqitur, do të kalojnë në të djathtën tuaj, të tjerët që janë kundër saj, do të vendosen në të majtë. Ata që nuk janë të sigurtë për qëndrimin që duhet të mbajnë, mund të qëndrojnë në qendër.
- Kush dëshiron të flasë, duhet të mbaj në dorë “mikrofonin fluturues”. Asnjeri nuk mund të flasë apo të ndërpresë të folurit e personit që ka në dorë mikrofonin fluturues. Kur personi të ketë përfundur fjalën, të tjerë mund të kërkojnë mikrofonin fluturues, të cilën ia jep edukatori.



- Gjithësecili ka të drejtë të lëvizi nga një grup në tjetrin në çdo moment, në funksion të argumentimeve që dëgjon në lidhje me problemin, madje mund të qëndrojë edhe në qendër kur e sheh se bindjet e tij po fillojnë të lëkunden. Asnjëri nuk duhet të ndiehet keq që po ndryshon mendim. Nuk është shenjë dobësie, por, në të kundërtën, është shenjë e të qenit të hapur për të dëgjuar mendimet e të tjerëve edhe kur ato janë të ndryshme nga të vetat.
- Nuk ka fitimtarë dhe të humbur. Qëllimi i ushtrimit nuk është të bësh me vete numrin më të madh të njerëzve, por të shprehësh mendimet e tua dhe të dëgjosh ato të të tjerëve.

Mikrofoni lëvizës mund të jetë çfarëdo sendi, mund të jetë dhe një mikrofoni i vertetë, kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka ajo çfarë përfaqëson, pra që është një mjet që të jep mundësi të shprehesh për një çështje. Duke përdorur një send tjetër në vend të mikrofonit, mund të ishte shkas për të përdorur një element humori në debat, pra është një element pozitiv. Ai do t'i ndihmojë të shfryjnë tensionin, të bëjë për të qeshur grupin dhe të ndihmojë në vendosjen e një klime bashkëpunuese.

Respektoni me rigorozitet rregullat në mënyrë që asnjëri të mos flasë pa patur në dorë mikrofonin fluturues. Vetëm kështu mund të ruani rregullin dhe t'u bëni të ditur të rinjve që të gjithë kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre, pavarësisht nëse janë pro apo jo me atë që thuhet. Të rinjtë do të kuptojnë konceptin e lirisë së fjalës, si dhe faktin që anëtarët e shoqërisë nuk kanë detyrimisht të drejtë apo gabim dhe se mund të mendojnë dhe të veprojnë në mënyra të ndryshme.

Kur të gjithë të kenë përvetësuar këtë koncept, mund të filloni.

- Njoftoni tezën dhe sigurohuni që të gjithë ta kenë kuptuar.
- Drejtojeni me pyetjen se kush dëshiron të hapë debatin. Nëse nuk ka vullnetarë, ftoni ndonjërin, që nuk ka shumë mbështetës, të shpjegojë arsyet e pozicionit që mbron. Mirë është që të rinjtë vullnetarisht të shprehin mendimet e tyre, por në rast



Debati lëvizës

të kundërt, ju do të moderoni debatin duke i zgjedhur “vullnetarët”.

- Pasi keni dëgjuar “argumentimin” e parë, pyesni grupin nëse ka ndonjeri që do të ndërhyjë. Dhe në këtë rast, është mirë që në dhënien e fjalës të respektoni vullnetin e të rinjve. Nëse asnjëri nuk dëshiron të flasë, ju mund t’i drejtoni mikrofonin lëvizës.
- Lëreni debatin të rrjedhë natyrshëm, duke ia kaluar mikrofonin kujtdo që dëshiron të flasë, por duke qenë i vëmendshëm për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet atyre që janë pro dhe kundër.
- Sigurohuni që të flasin edhe ata që qëndrojnë në qendër dhe të shpjegojnë pse janë të pavendosur. Pyetini nëse kanë ndryshuar mendim si rrjedhojë e argumenteve të paraqitura dhe nëse dëshirojnë t’i bashkëngjiten grupit majtas apo djathtas. Në këtë moment është e mundur që disa prej atyre që zgjodhën qendrën, të lëvizin në njërin apo tjetrin krah.
- Debati vazhdon derisa entuziazmi dhe gatishmëria e të rinjve për të shprehur opinonet e veta, është i madh.

Çdo debat përfundon kur grupi i ka shprehur të gjitha argumentet ose kur ju vetë e mbyllni, pasi për disa tema mund të diskutohet shumë gjatë. E rëndësishme është të nënvizoni konceptin se nuk mund të flitet me terma të tillë, si: e drejtë/ e gabuar, po/jo, e bardhë/e zezë apo të thoni që një grup fitoi dhe tjetri humbi. Në shoqëri kanë të drejtë të gjithë të kenë mendimin e vet. Në çdo shoqëri lindin probleme dhe pengesa serioze kur persona dhe grupe të veçanta njerëzish mbajnë qëndrime të bazuara në njohjen jo të plotë të problemit.

Ju do të jeni ata që do të vlerësoni interesin e grupit për debatin. Shpesh ndodh që pas thyerjes së akullit nga vullnetarët, të gjithë janë të gatshëm të shprehin opinonet e tyre në lidhje me çështjen.

Pohimet e hapjes

Edhe pse dihet që objektivi i ushtrimit është të nxitet debati për punën e fëmijëve, do të jetë shumë më mirë që biseda të fillohet më një farë humori që tërheq më shumë vëmendjen e të rinjve. Pasi të keni krijuar një klimë besimi reciprok ndërmjet pjesëtarëve, mund të kaloni në temën e punës së fëmijëve.

Argumentet dhe deklaratimet e hyrjes mund të jenë të ndryshme në varësi të vendit dhe kushteve në të cilën zhvillohet moduli. Kjo është arsyeja që nuk mund të këshillohen tema që të jenë kudo të vlefshme. Këto do t'i zgjidhni vetë, pasi, në varësi të trashëgimisë socialkulturore të grupit, edukatori është personi i vetëm në gjendje të gjejë temën e duhur që do të gjallëronte pozitivisht atmosferën e grupit.

Kur duhet të përzgjidhet tema e diskutimit, është mirë që të merret nga jeta shoqërore e të rinjve.

P.sh., nëse një grup muzikor është shumë i dashur për të rinjtë, mund të pohoni: “Elita 5 është një grup shumë i talentuar dhe është me taban kombëtar”.

Është e natyrshme që ndërmjet të rinjve do të ketë edhe nga ata që nuk e pëlqejnë. Por të gjithë të rinjtë e grupit nuk do ta kenë problem të shprehin mendimet e tyre në lidhje me grupin. Një alternativë tjetër është debati që mund të fillojë për një sport shumë popullor në vendin tuaj. Fillojeni këtë debat me një pohim të caktuar për një skuadër që praktikon këtë sport. Është e natyrshme që grupi do të ndahet në qëndrimet e veta në lidhje me skuadrën, por kjo do të bëhet paqësisht. Jepni argumente të ndryshme dhe parqitini ato me pohime të caktuara që nuk provokojnë tension në grup, por, përkundrazi, nënvizojnë aspektet argëtuese të ushtrimit.

Kur e ndjeni se grupi e ka kuptuar thelbin e ushtrimit dhe ka qenë aktiv, paraqisni temat kryesore të diskutimit. Po japim disa këshilla në lidhje për punën e fëmijëve. Ato lidhen me pohimet, të cilat duhet të jenë të forta dhe të nxisin reagimin e gjallë të pjesëmarrësve. Ato duhet t'i bëni me kujdes, madje duke futur edhe elemente të humorit. Në këtë rast, e rëndësishme është të mbani situatën nën kontroll. P.sh., pohimi që “gruaja duhet të qëndrojë në shtëpi”, mund të ngjallë një reagim të fortë tek vajzat e grupit dhe kjo gjë është pozitive. Në këtë rast, qëllimi nuk është që t'i imponoheni grupit, por që ju vetë të kuptoni më mirë pozicionin, duke siguruar sa më shumë informacion të jetë e mundur dhe të mbështesni diskutimin e hapur dhe të singertë. Qëllimi është të përforcojë marrëdhëniet në grup, të gjallërojë dinamikën e grupit dhe jo të thellojë kundërshtitë.



Temat kryesore

Më parë, diskutimi shtyhej në aspekte argëtuese. Tashmë ushtrimi bëhet më serioz edhe pse duhet të ruajë atmosferën e shkëmbimit të mendimeve në mënyrë të hapur dhe të sinqertë. Në këtë fazë, procesi i dëgjimit dhe i respektimit të mendimit të gjithësecilit është shumë i rëndësishëm. Manaxhojeni me kujdes dhe përpiquni të respektoni të gjitha pozicionet. Nëse e shikoni se debati apo diskutimi nxehet dhe ju del jashtë kontrollit, duhet të tërhiqni vëmendjen duke ndërhyrë dhe duke i kujtuar grupit që gjatë diskutimit nuk duhet të dilet me gjykime rreth mendimeve të kundërta, por duhet t'i respektoni të gjitha.

Ja disa pohime:

- Djemtë dhe vajzat kanë të njëjtën të drejtë për t'u arsimuar.
- Gruaja duhet të qëndrojë në shtëpi.
- Burrat dhe gratë kanë të njëjtën të drejtë për të punuar.
- Nëse mbijetesa e fëmijëve varet nga puna që bëjnë, atëherë bëjnë mirë që punojnë.
- Është e nevojshme të përcaktohen kushte të përshtatshme të punës si për djemtë, ashtu dhe për vajzat.

Këta janë vetëm disa shembuj dhe shpresojmë të nxisin ide të reja dhe të përshtatshme për grupin tuaj. Nuk duhet të zgjidhni pohime provokuese.

Veprimtaria 2: Debati formal

Dy orë mësimi më vete ose dy orë mësimi së bashku, si dhe koha që ju duhet për procesin e kërkimit dhe organizimin e provave.

Faza e parë e debatit formal kërkon të përcaktohet një temë apo një pozicion, i cili do të ballafaqojë të dyja qëndrimet. Pa dyshim, tema të jetë në lidhje me punën e fëmijëve. Dy janë alternativat e mundshme për edukatorin. E para, ndoshta më pak interesante, të cilën do ta paraqesni ju duke folur paraprakisht me grupin. E dyta është shumë më interesante dhe është në vijim të procesit pedagogjik dhe të klimës demokratike. Bëhet fjalë për organizimin e një sesiioni brainstorming (rrahje mendimesh) me të gjithë grupin për të nxjerrë në pah një numër të caktuar çështjesh.

Duke përgatitur disa mocione, mund të siguronit një sesion diskutimi ku të marrë pjesë i gjithë grupi. Një ndër pohimet që mund të përdoret në këtë fazë prove, është “vendi i fëmijës është në shkollë dhe jo në punë”. Ky pohim i vërtetë nuk mund të argumentohet vetëm duke thënë se puna e fëmijëve është e keqe e për rrjedhojë grupi që ka bërë këtë pohim, del fitimtar. Por grupi fitoi, pasi ngriti një çështje tjetër publikut, duke theksuar faktin që nuk mjafton vetëm të hiqen këta fëmijë nga puna, por duhet të diskutohen dhe të zgjidhen probleme të tilla, si: varfëria, papunësia dhe pamundësia për të patur vend në shkollë për këta fëmijë. Të gjitha këto dukuri, nëse nuk zgjidhen, mund të dënojnë këta fëmijë dhe familjet e tyre në një të keqe më të madhe, siç është varfëria ekstreme, madje dhe vdekja.

Pasi të jetë zgjedhur argumenti i debatit, duhet të përzgjidhen grupet e diskutimit. Nëse e njihni grupin dhe e dini se disa elementë janë më të përgatitur se të tjerët, përpikuni t'i ndani nëpër grupe dhe jo t'i lini të gjithë në një grup. Kjo gjë do të ndihmojë që debati të jetë i ekuilibruar, puna e arbitrave bëhet edhe më e vështirë dhe diskutimi më interesant për publikun.



Shënim për përdoruesin

Ky modul mund të jetë reaktivisht i gjatë. Nëse organizoni një konkurs, mund të jetë edhe më i gjatë. Gjithësesi planifikoni me kujdes të gjitha fazat e veprimtarisë në mënyrë që kur disa përgatiten për diskutimin dhe merren me punë kërkues, të tjerët të merren me çështje të tjera, në mënyrë që të gjithë të jenë pjesëmarrës në realizimin e tij. Një mënyrë tjetër është ta ndani grupin në një numër të përshtatshëm nëngrupesh dhe të caktoni një pohim për diskutim, ku tri nëngrupe të mbajnë qëndrimin pro dhe tri të tjera të mbajnë qëndrim të kundërt me pohimin. Më pas, të gjitha skuadrat do të tërhiqen për të shkruar dhe për të studiuar argumentet që do të sjellin, për të mbrojtur qëndrimin e tyre. Në këtë mënyrë, të gjithë do të kenë diçka për të bërë. Mund të ketë edhe ndonjë përsëritje, por gjithësecili do të shkruajë në stilin e vet.

Juria zgjidhet në çastin e fundit. Anëtarët e saj nuk kanë nevojë të kenë një përgatitje paraprake, vetëm se duhet të dëgjojnë në mënyrë të barabartë debatuesit dhe të vlerësojnë mbi bazën e cilësisë së trajtimit të argumentit dhe jo mbi bazën e motiveve personale. Pra, të gjithë pjesëtarët e grupit duhet të marrin pjesë aktivisht dhe kjo gjithashtu varet nga madhësia e grupit dhe informacioni që ka.

Përgatitja e debatit

Grupet e diskutimit do të mbledhen për të diskutuar për strategjinë që duhet të ndjekin në debat, për personin që do të përzgjedhin për t'u përgjigjur si dhe për të studiuar dhe për të shkruar diskutimin. Në këtë moment fillon dhe pjesa më e këndshme e ushtrimit. Nëse dëshironi, mund t'u paraqisni pjestarëve të grupit shtesën 1 të modulit, në mënyrë që të gjithë të kuptojnë rolin dhe detyrën që kanë. Gjithçka varet nga ju, nëse dëshironi t'i mbeten strikt rregullave të zhvillimit të debatit apo do të jeni me elastik, duke realizuar në të dyja rastet objektivin.

Në këtë fazë, edukatori dhe personat e jashtëm që janë ofruar për të ndihmuar, luajnë një rol të rëndësishëm. Për zhvillimin e strategjisë së debatit, për të kuptuar si t'u përgjigjen kundërshtarëve, si ta studiojnë argumentin dhe të parashtrojnë diskutimin etj., nëngrupet kanë nevojë për ndihmë. Secili nga nëngrupet duhet të mbledhet në një mjedis të qetë, i ndarë nga nëngrupet e tjera.

Për zhvillimin e debatit po japim disa këshilla, të cilat nuk duhet të zbatohen rigorozisht në renditjen e mëposhtme. Ju mund të shfrytëzoni vetëm ato që ju duken të përshtatshme për rastin tuaj.

- **Strategjia.** Grupet kanë nevojë të ndihmohen për t'u treguar si zhvillohet një proces kërkimor dhe si parashtrohet argumenti. Është mirë që të gjithë anëtarët e grupit të kenë një ide se çfarë do të thonë. Duhet bërë kujdes që të mënjanohet përsëritja e të njëjtave argumente, pasi kjo gjë mund të mërzisë jurinë dhe publikun. Sugjerojini grupit të studiojë me vëmendje çështjen dhe ta ndajë në disa nënçështje si pro, ashtu edhe kundër. Një strategji tjetër mund të jetë ajo që secili anëtarë i grupit të përqendrohet në një aspekt të punës kërkimore dhe në parashttrimin e problemit të gjithë të flasin njëri pas tjetrit, duke

paraqitur kështu një tezë me mendimin e gjithësecilit. Referuesi më i miri i grupit duhet të jetë në fund të paraqitjes, në mënyrë që të nënvizojë aspektet më të rëndësishme të tezës.

- **Përgjigjja.** Anëtarët e grupit mund t'u përgjigjen pyetjeve të ngritura nga pala kundërshtare. Grupi duhet të ketë një ide pak a shumë të qartë të qëndrimit të shprehur nga pala kundërshtuese dhe kolegialisht do të hartojë strukturën e përgjigjes që duhet të japë. Kjo etapë vjen pasi të jetë zhvilluar veprimtaria kërkimore dhe parashtrimi i materialit të mbledhur.
- **Kërkimi dhe hartimi i materialit.** Pasi të kenë biseduar se kush do ta paraqesë materialin dhe çfarë pikërisht do të paraqitet, secili anëtar i grupit studion tezën e vet dhe shkruan diskutimin. Koha e një diskutim është mesatarisht 3-5 minuta, jo më shumë. Gjithësesi, për të rinjtë nuk është e thjeshtë të flasin 5 minuta rresht para publikut, por është e rëndësishme që ata të flasin shkurt dhe saktë.
- **Paraqitja.** Kjo është pjesë formuese e ushtrimit dhe grupi ka nevojë për ndihmë. Është momenti ku ju mund të zbuloni talentet e të rinjve për aktrim. Paraqitja është po aq e rëndësishme sa dhe diskutimi, prandaj anëtarët e grupit duhet të mësohen ta deklamojnë duke përdorur edhe gjestet. Edhe kjo është një mundësi e mirë që ju jepet të rinjve për t'u ushtruar fillimisht të shkruajnë variantin e parë të diskutimit, ta përmirësojnë dhe më pas të nxjerrin shënime dhe skeda për zëdhënësin (skedat dhe shënimet janë në shtesën 1). Nuk duhet të lejoni që të rinjtë të lexojnë atë që kanë shkruar. Përdoreni këtë ushtrim me mjeshtëri dhe mësojuni të rinjve atë që ju dini rreth artit të të folurit në publik, duke veçuar disa aspekte të rëndësishme, si: vendosja e kontaktit viziv me publikun për të krijuar një lidhje personale; të folurit me qetësi dhe qartësi; pushimi që duhet të bëhet kur kalon nga një çështje e rëndësishme tek tjetra; ruajtja e ritmit të zakonshëm të frymëmarrjes etj. Para se të dalin në publik, të rinjtë të ushtrohen brenda nëngrupit, në mënyrë që




të përmirësojnë ato mangësi që mund të kenë. Nëse punojnë më vete, duhet të ushtrohen para pasqyrës. Gjithashtu, duhet të masin kohëzgjatjen e diskutimit në mënyrë që të respektojnë kohën që kanë në dispozicion.

Kjo mënyrë e të punuarit në grup forcon lidhjet dhe mbështetjen e ndërsjellë të të rinjve.

Debati

Së bashku me grupin duhet të merrni pjesë në përgatitjen e sallës apo të klasës ku do të zhvillohet debati. Në varësi të kohës, mund të vendosni ta zhvilloni debatin në një mjedis të hapur. Nëse keni mundësi, duhet të siguroni një tavolinë për jurinë, karrige për publikun dhe podium ku mund të rrinë debatuesit ose drejtuesi i debatit.



Më mirë është që ju të jeni drejtuesi i debatit, pasi i njihni pjesëmarrësit, dini edhe atë që do të thonë. Gjithësesi, ju së bashku me grupin vendosni se kush mund të jetë drejtuesi, ndoshta dhe një person i jashtëm. P.sh., në një mjedis shkolle, drejtori i shkollës mund të drejtojë debatin. Ose në prani të një publiku më të gjerë, debati mund të drejtohet nga një anëtar i këshillit drejtues të shkollës, nga një politikan, nga një përfaqësues i një OJF-je, nga një përfaqësues i sindikatës, nga një prind etj. Kjo është një mënyrë shumë e mirë për të përfshirë në këtë proces pedagogjik gjithë komunitetin. Nëse drejtuesi është një person i jashtëm, atëherë duhet të bëni përpjekje të ftoni edhe median lokale, në mënyrë që të mundë të pasqyrojnë në media debatin.

Kur të gjithë të kenë zënë vend, drejtuesi i debatit paraqet argumentin. Nëse debatin nuk do ta drejtoni ju, duhet që paraprakisht t'i jepni drejtuesit informacionin dhe shënimet e duhura për zhvillimin e tij. Pasi të ketë bërë të njohur argumentin, drejtuesi paraqet anëtarët e grupit dhe i fton një nga një të marrin fjalën për të mbajtur diskutimin e vet. Mirë është që drejtuesi, para se të kalojë në paraqitjen e radhës, bën një përmbledhje të diskutimit që pararendës. Drejtuesi duhet të bëjë kujdes që të alternojë diskutimet, duke ua dhënë fjalën me radhë të dyja grupeve, pro dhe kundra.

Mund të veprohet në dy mënyra. Mënyra e parë, për një çështje, ballafaqohen mendimet pro dhe kundër nga

përfaqësuesit e të dyja grupeve dhe kështu vazhdon për të gjitha çështjet e argumentit. Mënyra e dytë është më e thjeshtë, të rinjtë e të dyja grupeve paraqesin argumentet dhe, më pas, përfaqësuesit e secilit grup bëjnë përmbledhjen e të gjitha argumenteve pro dhe kundër.

Më pas, drejtuesi i debatit përmbledh për jurinë dhe publikun argumentet e të dyja grupeve dhe, ashtu siç keni rënë dakord, debati vazhdon me pyetje dhe komente që u drejtohen përfaqësuesve të grupeve. Ndërhyrjet dhe pyetjet duhet të bëhen brenda një kohe të përcaktuar, jo shumë e gjatë, të cilën duhet ta respektoni, në mënyrë që të ruhet ritmi dhe përqendrimi i të gjitha palëve pjesëmarrëse në debat.

Gjatë gjithë veprimtarisë, juria do të diskutojë qëndrimin dhe argumentimin e grupeve. Vlerësimi mund të bëhet në mënyrë informale në fund të çdo referimi, mund të bëhet edhe sipas rregullave që jepen në shtesën 1, ku secili referues vlerësohet me pikë (më i larti është 10 pikë), duke u përqendruar në cilësinë e argumentimit, metodën dhe mënyrën e paraqitjes.

Në përfundim, drejtuesi fton kryetarin e jurisë të japë vlerësimin e debatit, si dhe vendimin për grupin fitues. Në varësi të klimës së krijuar mund të përdorni edhe shpërblime për ata që fitojnë debatin. Sidoqoftë, duhet të jeni të ndërgjegjshëm për mënyrën si do të pritët çmimi. Nëse mendoni se elementi i garës nuk pritët mirë, mënjanojeni dhënien e çmimit, në të kundërtën jepeni, spese mund të jetë një element më shumë mobilizues për skuadrat.

Në varësi të mundësive që keni, nëse në debat janë ftuar persona të jashtëm, si përfaqësues të sindikatës, të OJF-eve, të prindërve apo dhe politikanë, në përfundim të debatit mund të organizoni një koktej. Kjo ka rëndësi kur debati zhvillohet në kuadër të ndëgjegjësimit afatgjatë dhe jep mundësi për një njohje dhe shkëmbim mendimesh dhe idesh ndërmjet grupit dhe të gjithë personazheve të sipërpërmendur që mund të ndihmojnë. Nga ana tjetër, e gjithë veprimtaria i ndihmon të rinjtë të rriten dhe të bëhen pjesë aktive e komunitetit dhe ndryshimit social.

Ideja e përfundimit me një koktej është veçanërisht e vlefshme kur në debat ftohen përfaqësues të medias, politikanë lokalë dhe përfaqësues të shkollave dhe autoritetet e arsimit. Nëpërmjet debatit, grupi dëshiron të përcjellë një mesazh të rëndësishëm dhe për këtë duhet të përdoren të gjitha mjetet. Veçanërisht gazetarët janë të ndjeshëm ndaj bisedave të lira, prandaj në përfundim të debatit duhet t'u krijohet kjo mundësi.

Veprimtaria 3

Konkursi dhe debatit

Kohëzgjatja varet nga koha që keni në dispozicion, dhe personat e përfshirë.

Në varësi të mjedisit në të cilin zhvillohet projekti, në kushtet e arsimit formal apo joformal, problemi i punës së fëmijëve mund të analizohet në kuadër të një konkursi. Konkursi e bën më interesant realizimin e modulit, si dhe rrit përfshirjen dhe ndëgjegjësimin e subjekteve të ndryshme në lidhje me punën e fëmijëve.

Në realizimin e veprimtarisë së konkursit-debat, duhet të planifikoni me kujdes: përzgjedhjen e arbitërve apo të jurisë, përfshirjen e personave të jashtëm që do të lehtësojnë në punën kërkimore dhe në zhvillimin me cilësi të debatit, përzgjedhjen e drejtuesit, përgatitjen e publikut dhe zhvillimin e temave të diskutimit. Ideja e këtij konkursi është mënjanimi me etapa i grupeve të diskutimit në momente të ndryshme të garës, duke arritur në përballjen përfundimtare të dy grupeve. Kjo formë gare zhvillohet në shumë raste dhe në shumë vende, madje edhe në nivel kombëtar (olimpiadat në lëndë të ndryshme). Gjithësesi, objektivi i këtij ushtrimi është që të përfshijë në ushtrim një grup gjithmonë e më të madh njerëzish.

Për të realizuar deri në fund këtë veprimtari, duhet të bëni një planifikim tepër të kujdesshëm. Është shumë e rëndësishme që konkursi të jetë transparent dhe i drejtë. Duhet të bëni kujdes të veçantë për zhvillimin e debatit përfundimtar që do të përbëjë një ngjarje të veçantë për komunitetin, pasi mund të ftohen edhe personazhe të njohur të tij. Duhet të shfrytëzoni deri në fund ngjarje të kësaj natyre, pasi jo vetëm motivojnë grupin, por i hapin rrugën realizimit edhe të moduleve të tjera.

Në organizimin e konkursit përfshini të gjithë grupin në mënyrë që gjithësecili të ndiehet pjesë përbërëse e veprimtarisë. Nëse në konkurs përfshihen grupe të tjera, mund të ndodhë që në takimin përfundimtar të mos ketë anëtarë nga grupi juaj. A nuk do të ishte kjo një situatë interesante? Realizimi i projektit në mjediset e shkollës nxit kuriozitet dhe kërshtëri ndërmjet nxënësve dhe mësuesve.




Kjo është një situatë që duhet të shfrytëzohet. Ju kujtojmë se shpërndarja e çmimit të parë dhe të dytë, mund të nxisë rritjen e pjesëmarrjes. Ndoshta njëra ndër detyra e grupit është që këto çmime t'i sigurojë nga ente apo ndërmarrje që veprojnë në komunitet, pasi në këtë mënyrë ato do të informohen për projektin dhe temën e konkursit.

Veprimtaria 4

Diskutimi ndërmjet anëtarëve të grupit, drejtuesit dhe publikut

*Kohëzgjatja sipas dëshirës
(një ose dy orë mësimi)*



Më poshtë po japim një ndër format e debatit tradicional.

Krijohet një komitet me anëtarë të zgjedhur nga të rinjtë, i cili, mbi bazën e pyetjeve që ka bërë publiku, hap një diskutim me drejtuesin dhe me publikun. Ky lloj debati është shumë i zakonshëm në radio a televizion, veçanërisht për tema të aktualitetit. Debatet e ndërtuara në këtë mënyrë në vetvete janë interesante, por për ju bëhen edhe më shumë të tilla, pasi ju jep mundësi të ftoni përfaqësues të komunitetit.

E gjitha kjo është e rëndësishme për përfshirjen e komunitetit si dhe për të zgjuar interesin e medias. Tema e diskutimit do të dalë nga takimi i mëparshëm, gjatë të cilit janë ballafaquar idetë. Më pas, me grupin duhet të

vendosni se kë duhet të ftoni për të marrë pjesë në përbërje të komitetit. Ju kujtojmë se duhet të ftoni persona me opinione të ndryshme, që gjatë debatit të jenë në qëndrime të kundërta. Një debat i tillë ngjall interes në publik dhe i ndihmon të rinjtë të njihen me këndvështrime të ndryshme ndaj problemit.

Në një diskutim të këtij lloji duhet të përfshihen tri grupe interesash: qeveria, punëdhënësit dhe punëtorët. Palët (sindikata dhe punëdhënësitë) janë diskutantë shumë aktivë. Ndoshta keni kërkuar ndihmën e sindikatës, ndoshta keni përfshirë në modul ndonjë punëdhënës apo përfaqësues së qeverisë lokale. Nëse nuk e keni bërë, tani është koha ta bëni, pasi do t'ju ndihmojë edhe për modulet e tjera. Në këtë mënyrë do të forconi lidhjet me komunitetin dhe do të përmirësoni procesin e përfshirjes së tij në problemet e projektit.

Ashtu si në veprimtaritë e mëparshme, edhe në këtë veprimtari duhet një punë përgatitore, aq më shumë kur përfshihen edhe persona të jashtëm. Pjesëmarrësit duhet të jenë njoftuar me kohë për temën e diskutimit, si dhe për disa nga çështjet që do të ngrihen nga drejtuesi gjatë debatit. Gjithashtu, për etikë, duhet të informohen për përbërjen e auditorit të gjithë ata që do ndërhyjnë. Në përgjithësi, përfaqësuesit e qeverisë, të punëdhënësve dhe puntorëve kur duhet të ndërhyjnë në veprimtari të tilla, dëshërojnë të jenë paraparakisht të informuar për pjesëmarrësit.

Ndërmjet atyre që mund të ndërhyjnë, mund të ketë dhe persona të tjerë që kanë marrë pjesë në projekt. Sigurimi i një diskutimi dhe debati të mirë kërkon që drejtuesi të jetë i përgatitur shumë mirë, prandaj dhe grupi duhet të bëjë kujdes në përzgjedhjen e tij. Drejtues mund të jetë ndonjë i ftuar, drejtori i shkollës, mësues, ndonjë personazh i shquar etj., por e rëndësishme është që paraprakisht të informohet shumë mirë për temën e debatit. Roli i drejtuesit është që diskutimin ta bëjë të rrjedhshëm. Pasi ata që do të ndërhyjnë, do të prezantohen. Roli i drejtuesit është që t'u bëjë pyetje për të sqaruar pozicionin e përfaqësuesve të grupeve, si dhe argumentimin e tyre për problemin. Drejtuesi duhet të armatohet me një listë me pyetje rreth temës së



debatit të përgatitur më parë, në mënyrë që të mos krijohen pauza dhe të garantohet vazhdimësia e dialogut.

Gjithashtu, drejtuesi mund të hapë diskutimin edhe për publikun, veçanërisht kur është thënë diçka për të cilën publiku nuk është dakord. Ky tip diskutimi është një rast shumë i mirë për të përfshirë komunitetin, një arsye më shumë për t'ju shtyrë të bëni sa më shumë publicitet për projektin. Në varësi të pjesëmarrjes, mund të shfaqet edhe interesi i medias për ta pasqyruar këtë veprimtari.

Elementi më i rëndësishëm i një diskutimi të mirë është drejtuesi dhe pikërisht tek ai ju duhet të përqendroni të gjitha energjitë. Duhet të përpiqeni të gjeni një person të vlefshëm dhe të gatshëm për ta luajtur këtë rol, i cili do të jetë në gjendje për të nxitur një debat të gjallë dhe interesant. Drejtuesi duhet të jetë në gjendje të mbushë hapësirat e heshtjes, të bëjë lidhjen ndërmjet trajtimit të një çështjeje me një tjetër, të interpretojë dhe të komentojë mendimet e shprehura nga publiku etj. Ky person duhet të jetë në gjendje të sintetizojë çështjet kryesore të diskutimit. Ndoshta kjo pjesë e diskutimit kërkon më shumë përgatitje dhe reflektim sesa thjesht debati, por rezultati mund të lërë gjurmë të vlefshme në komunitet.

Sigurohuni që i gjithë grupi të jetë aktiv dhe pjesëmarrës në përgatitjen e kësaj veprimtarie. Gjëja më e mirë është që grupi të shpërndahet ndërmjet të ftuarve dhe të përfaqësohet sa më mirë.

Çfarë duhet bërë dhe çfarë duhet mënjanuar

- Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë në të gjitha sesionet e modullit. Ndiemoni ata që kanë vështirësi në realizimin e veprimtarive kërkimore dhe të shkrimit, si dhe ata që ndiehen në vështirësi për t'u përballuar me publikun. Për shumicën, është një veprimtari e vështirë, por siguri i mbështetjes së duhur bën të mundur kapërcimin e vështirësive.
- Gjatë ushtrimit të debatit lëvizës bëni kujdes që në qendër të mos jenë të njëjtët persona, kryesisht “të pavendosurit”. Nëse shikoni që dikush ka kundërshtime për të paraqitur, jepjani fjalën duke i drejtuar mikrofonin që të shpjegojë arsyet e veta. Kur të gjithë të kenë shprehur mendimet e veta, pyetini ata që janë në qendër nëse kanë ndryshuar mendim dhe dëshirojnë të kalojnë nga njëra ose tjetra anë. Në raste të tilla, meqë u kërkohet, ata duhet të prenoncohen.
- Sigurohuni që të gjithë të marrin fjalën dhe diskutimi të mos monopolizohet nga më të shkathtit.
- Mundohuni që rregulli i mikrofonit të respektohet. Kur dikush ka në dorë mikrofonin, të gjithë të tjerët duhet ta dëgjojnë.
- Gjatë zhvillimit të sesionit përdorni batuta dhe humor. Edhe pse i zhvilluar në këtë frymë sesioni, ka vlerë të madhe. Gjithësesi, të rinjtë do të kuptojnë se çfarë kanë mësuar vetëm atëherë kur do t'i përdorin instrumentet e fituara në realizimin e moduleve të tjera ose në praktikë.
- Gjatë sesionit mos lejoni të bëhen kritika të ashpra. Sjellje të tilla krijojnë thyerje dhe prishje të dinamikës së veprimtarisë.
- Gjatë debatit mos lejoni që të tjerët të tallen me pozicionin që merr dikush, edhe nëse nuk ndajnë të njëjtin mendim. Ky modul ka si qëllim të edukojë respektimin dhe lirinë e të menduarit ndryshe të gjithësecilit.





- Bëni kujdes për dinamikën e grupit dhe reagimet individuale. Nëse dikush ndihet keq nga një opinion i shprehur, tregohuni të vëmendshëm ndaj tij. Pëpiquni të përfshini në ushtrim të gjithë, pa anashkaluar qëllimin e ushtrimit.
- Veçanërisht gjatë debatit lëvizës mos nguroni të mbyllni debatin nëse e shikoni se situata ju del jashtë kontrollit. Të gjithë duhet ta kenë të qartë se mospërputhja e mendimeve dhe respektimi i tyre bashkëjetojnë si një aspekt i rëndësishëm i respektimit të lirisë së njeriut.
- Duhet të jeni kërkues ndaj të rinjve, t'i mbështetni dhe t'i nxisni të marrin pjesë në gjithçka në përzgjedhjen e të ftuarve, në përgatitjen e veprimtarisë dhe përgatitjen e ftesave.
- Shfrytëzoni të gjitha mundësitë për të rritur shkallën e ndëgjegjësimit të opinionit dhe në këtë frymë duhet të punojnë të gjithë të rinjtë e grupit.
- Nëse keni mundësi filmoheni debatin. Filmimi mund të shfrytëzohet në shumë mënyra, si meazh promocional për të ndëgjegjësuar grupe të tjera apo si mjet pedagogjik për të ndihmuar grupin për të përmirësuar aftësitë e secilit për të folurit në publik, si dhe përmirësimin e teknikave të diskutimit.
- Nëse mendoni se grupi mund të manaxhojë një diskutim ndërmjet drejtuesit, diskutantëve dhe publikut, mos nguroni ta organizoni. Veprimtari të tilla janë shumë tërheqëse dhe përfshirëse për komunitetin
- Të gjitha diskutimet e bëra nga grupi duhet të ruhen.

Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Sesioni i vlerësimit është shumë i rëndësishëm. Nxirrni të gjitha shënimet që keni marrë. Nëse jeni ndihmuar nga një person i jashtëm, ftojini të marrë pjesë në këtë sesion. Debati është një veprimtari intensive dhe e lodhshme. Prandaj duhet të krijoni një mjedis të qetë dhe çlodhës për të zhvilluar vlerësimin. Jepuni mundësi të rinjve të shprehin rreth përjetimeve të tyre, të përshkruajnë në detaje si i kanë jetuar emocionet. Diskutoni veçantitë e debatit dhe të diskutimeve.

Jepuni fjalën të gjithëve dhe nxitini t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. Është interesante të mësoni pse disa kanë parapëlqyer të mbrojnë një tezë të caktuar dhe në ç'mënyrë i janë drejtuar publikut.

Është e natyrshme që disa diskutime të kenë qenë shumë të mira dhe të kenë tërhequr vëmendjen e publikut, por, gjithashtu, është e dobishme që të flitet për vlerën që kanë të gjitha diskutimet.


Flisni me grupin për përfshirjen në debat të publikut, veçanërisht nëse kanë marrë pjesë mjetet e komunikimit. Diskutoni si mund të vazhdojë kjo përvojë e fituar, falë njohurive të marra në modulën për mjetet e komunikimit. Nëse nuk e keni zhvilluar deri tani këtë modul, është koha për t'ua paraqitur të rinjve për të përforcuar kështu lidhjen e tyre me mjetet e komunikimit.

Nëse e keni filmuar debatin, është koha që t'ia shfaqni grupit. Do të jetë një moment i këndshëm dhe argëtues. Përqendrohuni në teknikën dhe mënyrën e shprehjes në publik dhe te mënyra si mund të përmirësohen ato.



Shënim për përdoruesin

Përdorimi i moduleve po bëhet gjithmonë e më i madh. Për rrjedhojë, po krijohet një material i bollshëm në lidhje me opinonet dhe argumentet që paraqiten për punën e fëmijëve, të cilat mund të përdoren shumë mirë për realizimin e këtij moduli. Për këtë, në emër të IPEC-ut ju ftojmë të na dërgoni temat e ndryshme që janë zgjedhur nga grupi për debatin, në mënyrë që të përdoren në formën e shembujve për të interesuarit. Në të njëjtën kohë, edhe diskutimet dhe materialet e filmuara janë shumë të dobishme.



Vlerësimi dhe vazhdimi



Në lidhje me përdorimin e treguesve të vlerësimit të modulit, të tillë ka dhe duhet t'i përdorni. Çdo i ri, në kuadrin e zhvillimit të debatit, duhet të ketë studiuar, të ketë shkruar dhe të jetë paraqitur një diskutim, për një çështje të caktuar të punës së fëmijëve. Cilësia e diskutimit varet nga individ, por në të njëjtën kohë varet edhe nga cilësia e zhvillimit të këtij moduli dhe moduleve të tjera, si dhe raporti që keni krijuar me grupin e të rinjve.

Hartimi i moduleve është bërë në mënyrë të tillë që të rrisë në vazhdimësi ndërgjegjësimin e të rinjve ndaj problemit të fëmijëve dhe t'i përfshijë ata emocionalisht në këtë proces, në mënyrë që të bëhen pjesëtarë aktivë në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Është një metod e të mësuarit shumë argëtues që me siguri do të lërë gjurmë të thella tek të rinjtë. Debati dhe të folurit në publik i bën të rinjtë më përgjegjës ndaj problemit, veçanërisht kur publiku përbëhet nga mësues, drejtori i shkollës dhe njerëz të njohur të komunitetit. Debati nxjerr në pah profilin artistik të gjithësecilit. Kur flasin para publikut, të rinjtë janë si në skenë ku interpretojnë një pjesë (kjo trajtohet më gjerë në modulet për lojën me role dhe dramatizimin. Kush do të ketë rezultate të mira në këtë veprimtari, do të bëhet një mbështetës i fuqishëm në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, ju këshillojmë të vazhdoni me njërin nga modulet për mjetet e komunikimit ose me modulin për lojën me role dhe dramatizimin.

Shtesa 1

Aftësitë kryesore në debat (shënime për edukatorët dhe pjesëmarrësit)

Debati

Debati në thelb është ballafaqim. Kjo nuk do të thotë se bëhet fjalë për një garë ku fiton ai që bërtet më shumë për të mbrojtur idenë e vet. Përkundrazi, debati zhvillohet mbi bazën e rregullave strikte, si dhe teknikave shumë të specializuara. Shpesh njerëzit ndodhen në pozicion të tillë që duhet të mbrojnë pikërisht atë që nuk besojnë.

Nëse debati është një formë ballafaqimi, është logjike që duhet të ekzistojë diçka për të cilën të ballafaqohesh. Pra është i ashtuquajturi “argument”, i cili ndryshon në varësi të debatit. Shpesh bëhet fjalë për argumente që paraqesin interes për një publik të gjerë. Të gjitha argumentet nisin me fjalën që, p.sh., argumenti i debatit për punën e fëmijëve mund të jetë: “Që fëmijët i përkasin shkollës dhe jo tregut të punës...”.

Si në të gjitha rastet, dhe ky argument ka dy faqe të medaljes. Grupi që është dakord me këtë pohim quhet pohues ose pro, ndërsa ai që nuk është dakord quhet mohues ose kundër. Kur zhvillohet një debat, është shumë e rëndësishme që argumenti të zgjidhet me kujdes në përshtatje me moshën dhe nivelin arsimor të të interesuarve. Në rastin e këtij projekti, argumenti duhet të paraqesë interes për pjesëmarrësit ose të jetë trajtuar në modulet e tjera.

Përcaktimi

Për të debatuar, duhet të përcaktohet paraprakisht objekti i debatit. Pra duhet të përcaktohet përmbajtja e argumentit. Përcaktimi i përmbajtjes së argumentit është i barazvlefshëm me përcaktimin e argumentit.

Puna për përcaktimin e argumentit fillon me grupin pohues. Zëdhënësi i parë i grupit pohues duhet të shpjegojë qartë kuptimin e argumentit sipas grupit. Në përcaktimin e argumentit, grupi duhet të udhëhiqet gjithmonë nga testi i “njeriut të rrugës”, që sipas të cilit, kuptimi që i jepet një argumenti, është i njëjtë me atë që ka një njeri në rrugë, nëse pyetet.

Grupi mohues mund të jetë dakord ose mund të kundërshtojë përcaktimin

e paraqitur. Në këtë fazë, grupi mohues duhet të bëjë shumë kujdes, pasi, nëse arrin të formulojë një përcaktim tjetër, zhvillimi i debatit bëhet edhe më i vështirë. Nëse propozimi i bërë nuk është i logjikshëm dhe nuk pranon pozicione të kundërta, mund të kundërshtohet. Nëse grupi mohues vendos t'i kundërvihet përcaktimit, atëherë zëdhënësi i këtij grupi do të paraqesë qartë motivet e kundërshtimit për të bërë më pas një përcaktim më të mirë.

Debati është një ngjarje që zhvillohet në grup dhe zakonisht për secilin grup ka tre zëdhënës. Të tre zëdhënësit duhet të punojnë ngushtësisht në grup. Linja kryesore e skuadrës është pikërisht pohimi themelor “pse argumenti i tyre është i vertetë” (për grupin pohues) dhe “pse argumenti nuk është i drejtë” (për grupin mohues). Zëdhënësi i parë formulon një frazë koncize që do të rimerret nga dy zëdhënësit e tjerë për ta përforcuar punën në grup.

Roli i zëdhënësve

Çdo zëdhënës duhet të luajë një rol të caktuar në secilën skuadër. Rolet po jepen më poshtë në rendin e marrjes së fjalës.

Zëdhënësi i parë pohues duhet të përcaktojë argumentin; të paraqesë linjën e skuadrës pohuese; të cekë shkurtimisht atë që do të thotë secili zëdhënës i skuadrës; të paraqesë qëllimin e parë të tezës pohuese.

Zëdhënësi i parë mohues duhet të pranojë ose të kundërshtojë përcaktimin (nëse nuk e bën, mendohet se përcaktimi është i saktë); të paraqesë linjën e skuadrës negative; të cekë shkurtimisht atë që do të thotë secili zëdhënës i skuadrës; të kundërshtojë disa nga momentet kryesore të zëdhënësit të parë pohues. Zëdhënësi i parë mohues duhet të përdorë 1/4 e kohës që kanë në dispozicion për kundërshtimin; të paraqesë qëllimin e parë të skuadrës negative.

Zëdhënësi i dytë pohues duhet të rimarrë linjën e diskutimit të skuadrës pohuese; të hedhë poshtë argumentet e paraqitura nga zëdhënësi i parë mohues. Ka në dispozicion 1/3 e kohës për të rrëzuar pikat e argumentit kryesor të skuadrës tjetër; të prezantojë pjesën e dytë të tezës pohuese.

Zëdhënësi i dytë mohues duhet të rimarrë linjën e diskutimit të skuadrës negative; të hedhë poshtë argumentet e paraqitura nga zëdhënësi i parë pohues. Zëdhënësi i dytë mohues duhet të përdorë afërsisht 1/3 e kohës në dispozicion për të hedhur poshtë argumentet e skuadrës tjetër; të paraqesë pjesën e dytë të tezës mohuese.

Zëdhënësi i tretë pohues duhet të rimarrë linjën e diskutimit të skuadrës pohuese; të hedhë poshtë të gjitha argumentet që kanë mbetur të tezës mohuese. Duhet të përdorë nga 2/3 deri në 3/4 e kohës që kanë në dispozicion

për të hedhur poshtë të gjitha argumentet; të paraqesë një sintezë të tezës pohues; të mbyllë debatin për skuadrën pohuese.

Zëdhënësi i tretë pohues duhet të rimarrë linjën e diskutimit të skuadrës mohuese; të hedhë poshtë të gjitha argumentet që kanë mbetur të tezës pohuese. Duhet të përdorë nga 2/3 deri në 3/4 të kohës që kanë në dispozicion për të hedhur poshtë të gjitha argumentet; të paraqesë një sintezë të tezës mohues; të mbyllë debatin për skuadrën mohuese.

Kundërshtues

Në debat secila skuadër do të prezantojë argumente në favor të tezës së vet. Gjithashtu duhet të kritikohen argumentet e skuadrës tjetër. Ky proces përcaktohet si proces kundërshtues . Më poshtë po japim disa aspekte të këtij procesi.

- *Logjika.* Të thuash që skuadra tjetër gabon, nuk mjafton. Duhet të thoni pse gabon. Duhet të merrni në analizë një argument kryesor të tezës së skuadrës kundërshtare dhe të tregoni që është i pabazë. Ky është një ndër momentet më të vështira, sepse duhet të mendosh shpejt, por njëkohësisht është shumë tërheqës.
- *Aftësi për të evidentuar pikat kryesore.* Për të hedhur poshtë argumentet kryesore të tezës së kundërshtarit. Më vonë bëhet më e lehtë t'i identifikosh. Natyrshëm këto pika mund të kapen kur zëdhënësi i parë cek shkurtimisht ato që do të thonë të tjerët. Por mos i hidhni poshtë këto argumente deri në momenti që nuk janë paraqitur tërësisht nga skuadra kundërshtare.
- *Korrektësi.* Më fjalë të tjera mos kritikoni zëdhënësit, por atë që ata thonë.

Zëdhënësi i vetëm

Secili zëdhënës është i lirë të përshtasë teknika të ndryshme, por do të votohet mbi bazën e tri elementeve kryesore: argumentim, metodë dhe mënyrë e paraqitjes.

Argumenti

Argumenti është ajo që thotë personi. Është thelbi i diskutimit. Diskutimi përbëhet nga argumentimi dhe shembujt. Një argumentim është një pohim: “argumentimi është i drejtë ose jo për x arsye” dhe në vend të x futet argumentimi. P.sh., në pohimin “Kopshtet zoologjike duhet të mbyllen”, një argument është se “Kopshtet zoologjike duhet të mbyllen sepse i burgosin kafshët në një mjedis jo të natyrshëm”.

Një shembull është një provë apo një fakt që mbështet argumentin. Nëse pohimi është “Kopshtet zoologjike duhet të mbyllen sepse i burgosin kafshët në një mjedis jo të natyrshëm”, një shembull mund të jetë që “në koopshtin zoologjik të qytetit ariu ka në dispozicion vetëm 100 m² për të lëvizuar, ndërsa në pyll ka afërsisht 2000 km²”. Çdo shembull duhet të jetë i përshtatshëm për argumentin.

Gjithësesi, argumentimi nuk mund të jetë një listë e gjatë shembujsh. Debatu nuk fitohet duke krijuar listën më të gjatë të shembujve. Faktet janë si tullat e një muri që, po nuk u lidhën mirë me llaç, nuk mbajnë. Në të njëjtën mënyrë nuk mund të fitohet një debat vetëm duke treguar se pala tjetër ka gabim. Nëse veproni kështu, mund të dobësoni paksa tezën, por është si të hiqni tulla të veçanta nga muri, ndërsa ju duhet të shkatërroni tërësisht murin.

Metoda

Ndërsa argumentimi është ajo që thuhet, metoda është mënyra se si thuhet. P.sh.:

- *Puna në skuadër.* Një punë e mirë në skuadër do të thotë unitet mendimi dhe logjikë e saktë. Uniteti përbëhet nga logjika e të gjithë anëtarëve të grupit që janë të ndërgjegjshëm për përcaktimin që kanë bërë, për atë që kanë thënë zëdhënësit, si dhe për qëndrimin që ka mbajtur skuadra. Secili anëtar duhet të mbështetë linjën e skuadrës dhe të jetë koherent me atë që kanë thënë anëtarët e tjerë.
- *Individual.* Secili zëdhënës duhet ta organizojë mirë diskutimin e tij. Hapi i parë është të kesh të qartë idetë që do të mbështesin argumentimin, si dhe shembujt që do të përdorësh. Kur të flasë, duhet të bëjë të qartë dallimin ndërmjet argumentimeve në mënyrë që publiku të ndajë qartë një argumentim nga tjetri. Bëhet fjalë të flasësh me pika që është një mënyrë shumë e rëndësishme në debat. Në radhë të parë, zëdhënësi duhet të ketë parasysh që ai flet për diçka që e njeh mirë, por nuk është kështu për publikun që nuk ka dëgjuar më parë për këtë problem dhe që me shumë gjasa do të jetë hera e parë dhe e fundit që e dëgjon. Pra është shumë e rëndësishme të jesh i qartë. Diskutimi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të respektojë kohën në dispozicion. Drejtuesi mund të ndërhyjë kur e sheh që zëdhënësi flet për të harxhuar kohën.

Mënyrat e paraqitjes

Mënyrat i referohen paraqitjes së diskutimit. Në lidhje me paraqitjen ka mundësi të shumta që zëdhënësit duhet t'i njohin. Nuk ka vetëm një mënyrë për të paraqitur një tezë. Më poshtë po ju japim disa këshilla dhe komente.

Skeda dhe shënime. Mos shkruani diskutimin në skedat e shënimit. Debati është një ushtrim ndërveprues dhe i gjallë ndërmjet dy skuadrave, madje edhe ndërmjet skuadrave dhe publikut, jo lexim i diskutimit. Skedat dhe shënimet përdoren për të kujtuar argumentin në një interpretim teatror. Janë pra një ndihmë për zëdhënësin, nëse do të kishte nevojë.

Kontakti pamor, që është i lidhur me skedat dhe shënimet. Nëse zëdhënësi i drejtohet publikut dhe e shikon në sy, mban gjallë vëmendjen e tij, por nëse lexon apo shikon mbi kokat e publikut, shumë shpejt do ta humbë përqendrimin. Pas vendosjes së kontaktit pamor, zëdhënësi duhet të vendosë lidhjen e duhur me zemrën dhe mendjen e publikut.

Zëri. Një zëdhënës për të qenë efektiv, mund të përdorë zërin e tij në shumë mënyra. Duhet të përdorë volumin, timbrin dhe shpejtësinë për të nënvizuar pikat e rëndësishme. Një ngritje e menjëhershme e zërit do ta shkundë publikun, duke rizgjuar vëmendjen, ndërsa një ton i ngrohtë mund të shërbejë për të rritur përqendrimin.

Trupi është një mjet që duhet të përdoret. Gjestet me duar duhet të jenë të thjeshta dhe të sigurta. Gjithashtu, zëdhënësi duhet ta lëvizë trupin dhe kokën për të ruajtur kontaktin me të gjithë komponentët e publikut. Nëse dëshiron të ecë poshtë e lartë, mund ta bëjë nëse e shikon se ka efekt. Nëse vendos të mos lëvizë, duhet të trasmetojë siguri në ato që thotë.

Tik nervoz. Duhet të mënjanohet në të gjitha situatat. Të lëvizësh nëpër duar skedën e shënimeve, të luash me kopsën e xhaketës, me flokët etj., shërbejnë vetëm për të hequr vëmendjen e publikut ndaj asaj që thuhet.

Diksioni dhe fjalori nuk janë ushtrime gramatikore, as ushtrime shqiptimi, por gjithësesi zëdhënësit duhet të kenë një diksion dhe shqiptim të pastër. Nuk fitojnë pikë nëse flasin më fjalë të mëdha, të cilave nuk ua dinë shqiptimin, madje ndonjëherë edhe kuptimin.

Vlerësimi me pikë

Debati vlerësohet nga një juri. Secili arbitër jep pikët mbi bazën e vlerësimit të një aspekti të paraqitjes. P.sh., maksimumi i pikëve është 100, që përbëhet nga 40 pikë për përmbajtjen, 40 pikë për mënyrën e paraqitjes dhe 20 pikë për metodën. Gjithësesi, grupi nuk duhet të merakoset për pikët dhe votat. Ajo që ka rëndësi, është pjesëmarrja dhe fitimi i aftësive të caktuara që do t'i ndihmojë të rinjtë në procesin edukativ, në profesion dhe në shoqëri